



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2024:039075

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876273

**P.nr.59/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm Penal sipas gjyqtarës së çështjes Laura Hoti Statovci duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër Nd.458/24 të datës 05.04.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.250/24 e datës 31.01.2024, kundër të akuzuarit L.H., për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 të KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), Gjykata më datën 28.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I.** APROVOHET marrëveshja nr. Nd.458/24 të datës 05.04.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarit L. H. në njërin ane dhe të dëmtuarit E. M. në anën tjetër.
- II.** HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.250/24 e datës 31.01.2024 dhe,
- III.** PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit L. H., për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPRK-së konform nenit 229 të KPPRK-së, për shkak se i akuzuari dhe i dëmtuari, kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.250/24 e datës 31.01.2024, kundër të akuzuarit L. H., për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata me datë 11.06.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me akordimin e palëve në procedurë e duke vepruar konform nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datë 05.04.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.458/24 të datës 05.04.2024 në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 05.04.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të KPPRK-së lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.59/2024 datë 28.06.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

---

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe i njëjti do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.